



Banka e Shqipërisë
Departamenti i Politikës Monetare



Komisioni Evropian*

VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT


5 JANAR 2024

** Vrojtmet e besimit bashkëfinancohen nga Bashkimi Evropian dhe Banka e Shqipërisë. Duke filluar nga muaji maj i vitit 2016, ato kaluan në programin e Komisionit Evropian për harmonizimin e Vrojtimeve të Besimit.*

VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT

Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) shënoi nivelin 111.9 në muajin dhjetor, me rritje prej 2.2 pikësh në krahasim me muajin nëntor, duke qëndruar 11.9 pikë mbi mesataren afatgjatë (Grafik 1). Përmirësimi i TNE-së u përcaktua nga rritja e besimit në sektorët e *ndërtimit*, *shërbimeve* dhe më pak nga ai i *industrialisë*. Sektori i *tregtisë*, si edhe *besimi konsumator* regjistruan vlera thuhajse të njëjta me një muaj më parë (Grafik 2).

Grafik 1. Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Treguesi i besimit të industrisë (TBI) u rrit lehtësisht me 0.5 pikë përqindje në muajin dhjetor, i ndikuar nga vlerësimet më optimiste për *kontratat porositëse*. Niveli i TBI-së aktualisht qëndron 7.3 pikë përqindje mbi mesataren historike (Grafiku 2). Pritjet e bizneseve të këtij sektori për *prodhimin*, për *punësimin* dhe çmimet në të ardhmen janë pothuajse të njëjta me ato të një muaji më parë (Tabelë 2, sektori i industrisë).

Treguesi i besimit në ndërtim (TBN) u rrit ndjeshëm me 9.1 pikë përqindjeje në muajin dhjetor, duke u ngjitur pranë vlerave më të larta historike. Ky tregues qëndron 30.3 pikë përqindje mbi mesataren afatgjatë (Grafik 2). Rritja këtë muaj u përcaktua nga vlerësimet më të larta për *aktivitetin aktual ndërtues* dhe për nivelin e *porosive* aktuale. Ndërkohë, edhe pritjet për *punësimin* dhe ato për çmimet në të ardhmen janë në rritje (Tabelë 2, sektori i ndërtimit).

Grafik 2. Treguesit e besimit sipas sektorëve*



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Shënim: *Grafiku paraqet vlera të standardizuara, për të korrigjuar ndryshimet ndërmjet mesatareve dhe devijimeve standarde të treguesve të besimit përkatës.

Treguesi i besimit në shërbime (TBSH) u rrit me 2.6 pikë përqindjeje në muajin dhjetor. Niveli i TBSH-së qëndron në intervalin e vlerave më të larta historike, rreth 16 pikë përqindje mbi mesataren afatgjatë (Grafik 2). Të dy komponentët përbërës të treguesit, *ecuria aktuale e aktivitetit* si dhe niveli i *kërkesës*, kanë regjistruar rritje. Pritjet e bizneseve për *kërkesën*, *punësimin* dhe *çmimet në të ardhmen* janë gjithashtu me rritje (Tabelë 2, sektori i shërbimeve).

Treguesi i besimit në tregti (TBT) qëndroi pothuajse i pandryshuar krahasuar me vlerën e një muaji më parë në muajin dhjetor. Kjo vlerë u ndikua kryesisht nga vlerësime të njëjta mbi *ecurinë aktuale të biznesit* dhe pritjet për *punësimin*. Niveli aktual i TBT-së qëndron rreth 7.7 pikë përqindje mbi mesataren historike (Grafik 2). Nga ana tjetër, pritjet për *ecurinë e biznesit* dhe *çmimet në të ardhmen* u vlerësuan në rritje (Tabelë 2, sektori i tregtisë).


Treguesi i besimit konsumator (TBK) në muajin dhjetor regjistroi vlerë të përafërt me atë të muajit paraardhës. Niveli i tij aktual ka kaluar me 1.3 pikë përqindje mesataren historike. TBK-ja këtë muaj u përcaktua nga pritjet pothuajse të pandryshuara për *situatën e përgjithshme ekonomike*, *situatën financiare* dhe *blerjet në shumën të mëdha për të ardhmen* (Grafik 2). Pritjet për nivelin e përgjithshëm të *çmimeve në të ardhmen* janë rishikuar për poshtë.

Treguesit me frekuencë tremujore¹. Balanca e gjendjes financiare të bizneseve në sektorin e *ndërtimit* është përmirësuar ndjeshëm, duke u zgjeruar me 10.6 pikë përqindje krahasuar me atë të një tremujori më parë. Në të kundërt, treguesi i gjendjes financiare shënoi rënie në sektorët e tjerë të biznesit. *Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve* është rritur, në krahasim me

¹ Pyetjet mbi gjendjen financiare dhe normën e shfrytëzimit të kapaciteteve kanë frekuencë tremujore. Ato përfshihen në pyetësorët e bizneseve të muajve mars, qershor, shtator dhe dhjetor.


tremujorin e tretë, në sektorin e ndërtimit (+5.1 pikë përqindje, duke u ngjitur në nivelin 77%) dhe lehtësisht në atë të industrisë. Sektorët e tregtisë dhe të shërbimeve rezultuan me rëniet respektive prej -3.8 dhe -1.8 pikë përqindjeje.

Grafik 3. Situata e biznesit sipas sektorëve, gjatë muajve të fundit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Pritjet për situatën e biznesit gjatë muajve të ardhshëm




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5. Pritjet për papunësinë dhe çmimet e konsumatorëve për 12 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Blerjet në shuma të mëdha të konsumatorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Treguesit e besimit sipas sektorëve*

	Vlerat			2023						Situata aktuale	
	min	mes	max	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Koniunkturale**	Strukturelle***
Industri	-60.8	-9.6	6.1	1.6	-3.1	-0.6	-3.8	-4.2	-3.8	↑	+
Ndërtim	-58.2	-22.5	9.8	-2.6	1.4	-8.6	-9.5	-4.7	4.4	↑	++
Shërbime	-45.4	9.4	35.2	23.4	29.9	24.9	24.2	20.5	23.1	↑	+
Tregti	-32.8	0.0	17.0	13.3	10.7	10.5	8.3	6.6	6.3	↓	+
Konsumator	-40.3	-26.6	-16.3	-27.0	-27.3	-26.9	-24.1	-24.8	-25.2	↓	+

Burimi: Vërtetimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

*) Treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara për sezonalitet. Balancat minimale, mesatare dhe maksimale, janë të llogaritura duke filluar nga muaji maj 2016.

**) Situata krahasuar me muajin e mëparshëm.

***) Situata për secilin tregues konsiderohet: shumë e kënaqshme (++), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e kënaqshme (+), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e pakënaqshme (-), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe shumë e pakënaqshme (--), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.

Tabelë 2. Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë (në pikë përqindje)

	2023								
	Prill	Maj	Qersh.	Korr.	Gusht	Shtat.	Tetor	Nëntor	Dhjetor
INDUSTRIA									
Prodhimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBI-së)	25.4	29.1	25.7	23.4	19.8	21.5	12.1	15.4	4.9
Kontratat porositëse (pyetja 2, komponent i TBI-së)	-1.5	-5.1	-4.4	-9.3	-13.5	-10.3	-10.8	-9.0	-3.1
Kontratat porositëse nga eksportet (pyetja 3, komponent i TBI-së)	-10.4	-5.7	-3.2	-9.4	-15.6	-12.8	-12.8	-19.1	-13.1
Inventari i produkteve të përfunduara (pyetja 4)	-4.2	-2.7	1.1	0.0	3.6	3.2	-3.2	-3.3	-2.0
Prodhimi, pritje (pyetja 5)	37.6	33.4	29.6	31.2	24.8	29.8	31.8	31.8	29.8
Çmimet e produkteve pritje (pyetja 6)	16.9	18.7	18.1	16.9	9.9	17.7	13.0	21.5	21.7
Punësimi, pritje (pyetja 7)	16.8	15.7	12.2	7.9	10.6	9.4	10.1	8.4	8.7
NDËRTIMI									
Aktiviteti ndërtues gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBN-së)	21.2	28.6	30.9	14.2	21.7	7.5	8.4	17.0	23.8
Kontratat porositëse (pyetja 3, komponent i TBN-së)	-17.0	-14.7	-11.3	-19.3	-18.8	-24.6	-27.4	-26.4	-15.0
Punësimi, pritje (pyetja 4)	15.5	13.6	15.7	9.2	12.6	5.4	11.3	13.1	16.2
Çmimet, pritje (pyetja 5)	19.9	20.1	26.3	26.5	17.1	20.5	8.2	15.5	19.8
SHËRBIME									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBSH-së)	22.9	38.8	31.2	20.8	29.8	25.5	23.9	17.9	22.3
Kërkesa gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 2, komponent i TBSH-së)	25.3	31.6	33.7	26.0	30.0	24.4	24.6	23.0	23.8
Kërkesa, pritje (pyetja 3)	28.8	29.0	28.9	29.6	30.7	25.5	30.4	33.1	35.0
Punësimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 4)	12.4	16.6	16.0	14.8	11.3	6.1	4.5	7.6	7.9
Punësimi, pritje (pyetja 5)	9.3	13.0	12.8	11.3	11.0	9.9	12.8	11.1	13.3
Çmimet, pritje (pyetja 6)	8.7	12.6	13.4	15.8	17.6	14.0	13.0	17.2	20.1
TREGTIA									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBT-së)	16.0	20.8	19.7	23.5	18.7	18.5	13.9	10.4	10.3
Gjendja e inventarëve (pyetja 2)	3.8	5.0	0.6	0.4	4.3	0.8	2.1	3.1	3.4
Pritje për porositë në të ardhmen (pyetja 3)	29.3	22.9	25.1	16.9	21.4	23.1	29.3	21.7	23.9
Ecuria e biznesit, pritje (pyetja 4)	27.0	26.4	26.2	18.5	23.6	17.4	27.5	25.8	26.8
Pritje për ecurinë e punësimit (pyetja 5, komponent i TBT-së)	5.5	3.4	5.5	3.1	2.8	2.5	2.7	2.8	2.4
Pritje për ecurinë e çmimeve (pyetja 6)	10.8	23.4	13.8	18.5	7.7	14.5	9.2	10.0	13.5
KONSUMATORI									
Situata financiare aktuale (pyetja 1)	-15.2	-13.9	-13.7	-15.9	-14.6	-13.5	-11.5	-10.9	-9.7
Situata financiare, pritje (pyetja 2, komponent i TBK-së)	6.1	4.2	4.0	1.5	0.5	1.8	4.3	4.7	4.4
Situata ekonomike aktuale (pyetja 3)	-24.7	-24.0	-22.7	-23.9	-23.5	-21.8	-19.8	-19.0	-18.9
Situata ekonomike, pritje (pyetja 4, komponent i TBK-së)	2.7	2.6	1.0	-0.3	0.8	0.2	1.0	3.9	2.9
Çmimet aktuale (pyetja 5)	49.1	44.1	46.5	51.0	51.9	46.8	45.6	46.6	44.3
Çmimet, pritje (pyetja 6)	-4.1	-7.6	-5.4	-0.1	4.1	-3.6	-6.9	-5.4	-3.3
Papunësia, pritje (pyetja 7)	-0.9	-0.9	-0.1	2.6	1.5	0.2	-4.1	0.9	3.1
Blerjet e mëdha aktuale (pyetja 8, komponent i TBK-së)	-59.1	-60.4	-57.9	-61.6	-61.2	-61.2	-57.0	-59.9	-62.0
Blerjet e mëdha, pritje (pyetja 9, komponent i TBK-së)	-48.1	-48.8	-47.6	-47.8	-49.3	-48.6	-44.8	-47.9	-46.1
Kursimi aktual (pyetja 10)	-42.0	-42.9	-43.6	-45.4	-44.3	-45.1	-44.2	-45.2	-42.2
Kursimi, pritje (pyetja 11)	-40.0	-39.6	-39.5	-42.6	-43.1	-43.3	-41.6	-42.2	-41.9
Situata e të ardhurave dhe shpenzimeve (pyetja 12)	3.2	4.0	2.6	0.0	-0.8	-0.6	3.9	2.0	3.0

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

ANEKS

Shpjegime metodologjike

Balanca është treguesi që përdoret më shpesh për agregimin e të dhënave cilësore nga vërtetimet. Ajo llogaritet si diferencë midis përqindjes së përgjigjeve pozitive dhe përqindjes së përgjigjeve negative. Balanca shprehet në pikë përqindje.

Treguesi i Besimit (TB) ndërtohet për çdo sektor dhe llogaritet si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht të treguesve, të cilët kanë korrelacionin më të lartë me serinë e referencës (serinë e të dhënave reale të ekonomisë).

Treguesi i Ndjesisë Ekonomike (TNE) ndërtohet duke u bazuar në të njëjtat balanca që përdoren për ndërtimin e TB-ve për secilin sektor (industri, ndërtim, shërbime, tregti dhe konsumatorë), duke synuar të kapë aktivitetin e ekonomisë në vend. Para agregimit të TNE-së, këto balanca standardizohen dhe peshohen.